



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 17.4.2024

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 17.4.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lidhur me rishikimin e vendimit të Kolegjit (JR) nr. 6, datë 28.2.2019, dhe rigjykimin e çështjes gjyqësore, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 42, datë 18.7.2018

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit zhvilloi, më datë 11.3.2024, seancën gjyqësore publike lidhur me kërkesën e ish – subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 6, datë 28.2.2019, në referencë të vendimit të GJEDNJ-së: “*Sevdari kundër Shqipërisë*”.

Trupi gjykues, me shumicë votash, ndër të tjera, vendosi pranimin e kërkesës së kërkueses, Antoneta Sevdari, për rishikimin e vendimit të Kolegjit (JR) nr. 6, datë 28.2.2019; prishjen e këtij vendimi dhe rigjykimin e çështjes gjyqësore, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 42, datë 18.7.2018.

Komisioneri Publik, paraprakisht, në raport me rigjykimin e kësaj çështjeje dhe vazhdimin e gjykimit të saj në themel, vendos në vëmendje që *shkaqet konkrete* të paraqitura në ankimin e datës 29.8.2018 të Komisionerit Publik, kundër vendimit të Komisionit nr. 42/2018, janë bazuar në gjendjen që janë aktet në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit, dhe mbeten të tilla, dhe pas administrimit të vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), nr. 40662/19, datë 13.12.2022.

Në vendimin e GJEDNJ-së, në raport me shkaqet konkrete të ankimit dhe problematikave të ngritura nga Komisioneri Publik, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe me kriterin e aftësive profesionale, të vlerësuara nga Kolegji dhe të arsyetuara në vendimin (JR) nr. 6/2018

të Kolegjit, nuk konstatohet ndonjë element i rëndësishëm, që përbën shkak për rishikim analitik të ndryshëm të këtyre shkaqeve të ankimit, të parë në raport me ndonjë rrethanë të re të zbuluar rishtazi, duke bërë dallimin ndërmjet fakteve të ndodhura para marrjes së vendimit përfundimtar¹ dhe fakteve të ndodhura pas marrjes së tij.

Në rastin konkret, rrethana e re e krijuar *a posteriori* është vendimi i GJEDNJ-së, i cili ka konstatuar shkelje të së drejtës së kërkueses për të respektuar jetën e saj private, sipas nenit 8 të Konventës për shkarkimin e saj, duke u shprehur, ndër të tjera, në vendim, se në rrethanat specifike të çështjes së saj, shkarkimi nuk ishte proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura².

Komisioneri Publik konstaton se vendimi i GJEDNJ-së, lidhur me shkaqet e ankimit, ndër të tjera, shprehet se:

[...] **88.** *Shkarkimi i kërkueses mbështetet në vlerësimin e pasurive të saj dhe në vlerësimin e kompetencës së saj profesionale. Në lidhje me vlerësimin e pasurive, në fillim Gjykata vëren se të gjitha rastet e mosdeklarimit të mjaftueshëm ose të mosjustifikimit të pasurive për qëllime të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit të konstatuara nga KPA-ja kishin lidhje në mënyrë ekskluzive me të ardhurat e fituara nga bashkëshorti i saj nga punësimi jashtë vendit dhe jo me të ardhurat e saj personale. Ajo gjykon se, në këto rrethana, është i nevojshëm një kujdes i veçantë për vlerësimin e proporcionalitetit në shkarkimin e saj.*

94. *Në lidhje me vlerësimin e kompetencës profesionale të kërkueses, qasja e vetme që KPA-ja kishte kundër saj, ishte fakti se ajo nuk kishte respektuar një afat për dorëzimin e apelimit në një çështje... Gjykata nuk nënvlerëson në këtë këndvështrim rëndësinë e ndjekjes penale të veprave penale të pretenduara me natyrë ekonomike nga zyrtarët publikë për ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, ajo gjykon se, për sa më sipër, në këndvështrimin e KPA-së, mosdorëzimi nga ana e kërkueses e një apelimi kishte qenë një incident i izoluar në karrierën e saj si prokurorë, e cila kryesisht trajtonte rastet e krimeve ekonomike. Nuk është argumentuar nëse çështja konkrete, e cila përfshinte një ish-zyrtar të qeverisë lokale, ishte e një profili veçanërisht të lartë. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt, Gjykata i referohet opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, se apelimi konkret do të duhej të dorëzohej duke pasur në konsideratë udhëzimet e përgjithshme për paraqitjen e apeliemeve të Prokurorisë, por ky apelim nuk kishte pasur ndonjë perspektivë të arsyeshme për të pasur sukses.*

145. *... Në këtë mënyrë, duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes konkrete dhe për sa mund të ishte e mundur sipas ligjit vendës, një formë e përshtatshme korrigjimi për shkeljen e të drejtës së kërkueses, për respektim të jetës së saj private, sipas nenit 8 të Konventës, do të ishte rihapja e procesit, nëse kërkuesja e kërkonte një rihapje të tillë, si edhe rishqyrtimi i çështjes në mënyrë të tillë që është në përputhje me parashikimet e nenit 8 të Konventës, ashtu siç përcaktohet në këtë vendim [...].*³

Sa më sipër, referuar nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelit ushtron funksionet e tij si institucion i pavarur dhe i paanshëm, mbi bazën e parimeve të barazisë

¹ Siç parashikon neni 494/a, i K. Pr. Civile, rastet e rishikimit kur zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj.

² Referohuni prg.143, të vendimit të GJEDNJ-së: Sevdari kundër Shqipërisë.

³ <https://kpa.al/wp-content/uploads/2023/04/Vendim-A.-Sevdari-13.03.2023.pdf>

përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të *proporcionalitetit* dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Mbi bazën e këtyre parimeve, në rastin e ankimeve të Komisionerit Publik, është Kolegji që shqyrton çështjet dhe vendos standardet në bazë të parimeve kushtetuese kur gjykohet çështja prej tij, duke konkluduar në vendimmarrje sipas nenit 66 të ligjit nr. 84/2016.

Në vijim të sa më sipër, Komisioneri Publik, në një rivlerësim të akteve në dosje të Komisionit, referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit, çmon se në rastin e procesit të rivlerësimit të kërkueses, znj. Sevdari, mbetet e paprovuar e kundërta e barrës së provës, për sa do të trajtojmë në vijim:

A. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë

Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, në zbatim të nenit D, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, kërkuësja ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së Deklaratën e pasurisë “Vetting” (më datë 25.1.2017), bashkëlidhur dokumentacionin mbështetës. Nga krahasimi i kësaj deklarate me deklaratat periodike të pasurisë, ndër të tjera, rezulton se znj. Sevdari ka deklaruar:

1. Pasuria (1): Tokë-arë me sip. 350 m² dhe (2) shtëpi banimi (4 kate), ndodhur në Tiranë.

1.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti deklaron:

(1) Tokë-arë, me sipërfaqe 350 m², në bashkëpronësi të personit të lidhur/bashkëshortit, z. ***, ***, vëllait të tij (***, ***) dhe nipit të bashkëshortit të subjektit (***, ***), në vlerën 700.000 lekë, blerë në vitin 2001. Pjesa takuese për 1/3 e pasurisë, në bashkëpronësi me bashkëshortin. **Burimi i krijimit:** kursimet familjare të bashkëshortit, të krijuara kryesisht nga puna si emigrant në Greqi, në vitet 1997-2000.

(2) Shtëpi banimi, e ndërtuar në mënyrë informale mbi tokën e sipërcituar, gjatë viteve 2001-2002. Vlera e shpenzuar për ndërtimin e pjesës zotëruese, për 1/3, është 3.000.000 lekë. **Burimi i krijimit:** nuk deklarohet.

1.2 Në deklaratën vjetore të vitit 2003 (dorëzuar në mars të 2004), pasuria tokë-arë, deklarohet në vlerën 1.400.000 lekë,⁴ me pjesë takuese 50%. **Burimi i krijimit,** deklarohen të ardhurat familjare dhe emigracioni i bashkëshortit. **Shtëpia e banimit,** ndërtuar mbi tokën-arë, deklarohet me sipërfaqe 140 m² dhe me vlerë 3 milionë lekë, me pjesë takuese 25%. **Për burimin e krijimit** deklarohet: “E ndërtuar vetë, me të ardhura familjare, emigracioni i bashkëshortit”.

1.3 Lidhur me burimin e krijimit të shtëpi banimi (4 kate), gjatë hetimit administrativ të Komisionit⁵, subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave, kanë qenë: (1) kursime të bashkëshortit (si emigrant ekonomik në Greqi) dhe prindërve të tij, të krijuara përpara vitit 2001, gjatë jetës së tyre dhe (2) të ardhurat e bashkëshortit nga puna në Arabinë Saudite, në vitin 2003. Në vitin 2003, bashkëshorti punoi për 5 muaj në Arabinë Saudite dhe të ardhurat e përfituara për punën e kryer ishin 12.000 euro. E gjithë kjo pagesë ka shkuar për të paguar punime të brendshme në banesë, në vitin 2003, si dhe një pjesë për mobilim.

⁴ Vlerë kjo e deklaruar më datë 8.11.2006, referuar akteve të ILDKPKI-së (DV-2003 mban shënim këtë datë, gjithashtu, në seksionin ku deklarohet kjo pasuri).

⁵ Referohuni pyetësorit të datës 27.2.2018.

1.4 Referuar deklaratës vjetore për vitin 2003, të ardhurat e bashkëshortit deklarohen 310.000 lekë (deklaruar 0.31 milion lekë, shuma neto), nga puna pranë shoqërisë “**** **”. Gjithashtu në deklaratat vjetore për vitin 2004 dhe 2005, të ardhurat vjetore nga paga të bashkëshortit pranë shoqërisë “**** **” deklarohen në shumën nga 400.000 lekë për secilin vit.

1.5 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, për këtë pasuri, ka arsyetuar se *znj. Sevdari ka dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumentacion, i cili e ka bindur trupin gjykues lidhur me krijimin e kësaj pasurie, herët në vitet 2000-2002, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe familjarët e tij. Znj. Antoneta Sevdari, fillimisht, nuk ka qenë pjesëtare e kësaj familjeje, më tej ajo ka qenë studente e magistraturës dhe nuk ushtronte funksionin e prokurores. Ajo nuk ka kontribuar në blerjen e kësaj pasurie dhe as investuar për ndërtimin e saj.*

1.6 **Komisioneri Publik**, referuar gjendjes së akteve në dosje për këtë pasuri, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, konstaton sa në vijim:

1.6.1 *Lidhur me deklarinimet mbi burimin e krijimit të pasurisë, Godinë 4 kate.* Kërkuesja, në pyetësorin e datës 27.2.2018, ka deklaruar se ceremonia e martesës me bashkëshortin është kryer në tetor të vitit 2000 dhe celebrimi është kryer në mars të vitit 2001. Me përafërsi, vlera e ndërtimit të pjesës së tyre takuese ka qenë 3.000.000 lekë. Godina katër kate është ndërtuar në mënyrë informale në vitet 2001-2002, ku në fund të vitit 2002, ishte përfunduar ndërtimi i të gjitha kateve, karabina dhe muret, por jo të gjitha punimet e brendshme. Kur znj. Sevdari ka kryer deklarinimin e parë, shtëpia ishte ndërtuar dhe mobiluar (gjithmonë për pjesën e tyre takuese) dhe ishte pothuajse *në gjendjen që gjendet dhe sot.*

1.6.2 Lidhur me kursimet për vitin 2000-2002 dhe burimin e krijimit të tyre, në përgjigje të pyetjes nr. 2, fillimisht, kërkuesja ka deklaruar se burimi i kursimeve kanë qenë paratë e fituara në emigracion nga bashkëshorti në Greqi dhe kursime familjare të prindërve të bashkëshortit, të krijuara deri në momentin kur ata erdhën të banojnë në Tiranë. Këtë burim të ardhurash, kërkuesja e ka deklaruar dhe në DV-2003, ku referuar deklarinimeve të vetë subjektit, shtëpia ishte ndërtuar dhe mobiluar.

1.6.3 Ndërkohë, vetëm në pyetësorin e datës 27.2.2018, në përgjigje të pyetjes nr. 3, ka deklaruar si burim për ndërtimin e kësaj godine dhe të ardhurat e bashkëshortit, në vlerën 12.000 euro, nga puna si gjeodet në Arabinë Saudite, të padeklaruara në Deklaratën e pasurisë (Vetting) 2017 dhe as në deklarinimin vjetor të pasurisë në vitin 2003 (dorëzuar në ILDKPKI në 24.5.2004).

1.6.4 *Lidhur me dokumentacionin provues, në funksion të deklarinimeve të kërkueses, mbi burimin e krijimit të pasurive që ajo dhe personi i lidhur zotërojnë*

1.6.5 (1) **Për burimin e ligjshëm të të ardhurave, të deklaruara nga emigracioni** i personit të lidhur/bashkëshortit, gjatë viteve 1997-2000⁶, Komisioni ka administruar vetëm tri dokumente të lëshuara nga Instituti Grek i Sigurimeve Shoqërore, të cilat vërtetojnë blerje

⁶ Rezulton se znj. Sevdari, së bashku me bashkëshortin e saj, kanë lidhur martesë ligjore në mars të vitit 2001 (referuar pyetësorit të KPK-së, të datës 27.2.2018) dhe subjekti i rivlerësimit është emëruar prokurore në tetor të vitit 2002. Pasuria “trual” është blerë në korrik të vitit 2001 dhe banesa e tyre, në vlerën 3.000.000 lekë, dhe mobilimi, në vlerën 3.000-4.000 euro, i përket periudhës 2001-2003 (referuar deklarinimit të vetë subjektit gjatë hetimit administrativ të KPK-së).

pullash sigurimi shoqëror, për muajt korrik, gusht dhe shtator, të vitit 1998. Këto akte nuk provojnë nëse ato lidhen me punësimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, ato figurojnë vetëm për një periudhë tremujore punësimi dhe jo për periudhën trevjeçare të deklaruar nga kërkuesja.

1.6.5.1 Në përgjigjet e pyetësorit të datës 16.4.2018, kërkuesja, znj. Sevdari, ndër të tjera, ka deklaruar se *bashkëshorti ka punuar si emigrant ekonomik në Greqi në vitet 1997-2000. Ai deklaroi se nuk e di vlerën e tatimit që është paguar për të ardhurat e siguruara prej tij, por di që tatimi është paguar nga punëdhënësi në burim, edhe për shkak të faktit që, për të vazhduar qëndrimin në këto shtete, duhet të sigurojë leje qëndrimi, dokumentacion, i cili nuk lëshohet nëse nuk vërtetoje marrëdhënie të rregullta punësimi dhe të ardhurash.*

1.6.5.2 Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga emigracioni, referuar pikës 21 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së⁷, deklarimi duhet të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklarimit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë. Në aktet në dosje, ashtu sikurse dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje në Kolegj, subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues, duke mbetur të ardhurat e deklaruara, për efekt të kontrollit gjatë procesit të rivlerësimit dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, në nivel deklarativ.

1.6.5.3 Në këtë kontekst, sa i takon ligjshmërisë të burimit të të ardhurave nga emigracioni i bashkëshortit në Greqi, Komisioneri Publik, gjithashtu, nënvizon se Kolegji tashmë ka jurisprudencë të konsoliduar në drejtim të fakteve, të cilat do të duhet të provohen, me qëllim që të kualifikohen si të ardhura të ligjshme dhe, për rrjedhojë, të shërbejnë si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt kontrolli të ardhurat me burim emigracionin e subjektit të rivlerësimit apo të personave të lidhur me të.

1.6.5.4 Në kuadër të qëndrimeve të Kolegjit lidhur me këtë çështje⁸, të ardhurat e pretenduara nga kërkuesja, me burim emigracionin e bashkëshortit në Greqi, nuk provohen se përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk rezultoi të jetë provuar niveli i këtyre të ardhurave, fakti që për to janë paguar tatimet në shtetin e origjinës, si dhe dërgesa e tyre nga vendi i origjinës në Shqipëri, në periudhën e deklaruar. Konsiderimi i remitançave nga emigracioni si të ardhura që nuk rrjedhin nga një burim i ligjshëm, nëse për to nuk arrihet të vërtetohet se janë paguar detyrimet tatimore, është një qëndrim i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit.

1.6.6 (2) **Për burimin e ligjshëm të shumës 12.000 euro**, konstatojmë se subjekti ka paraqitur një deklaratë nga shoqëria “****” sh.p.k., e datës **.1.2017, ku administratori i kësaj shoqërie deklaroi se bashkëshorti i subjektit, z. ***, ***, për periudhën qershor-dhjetor 2003, ka punuar në Arabinë Saudite dhe është paguar nga kjo kompani në shumën 12.000 euro, brenda vitit kalendarik 2003. Ndërsa, në përgjigjen e dytë⁹, kjo shoqëri pranon se nuk disponon asnjë

⁷ “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’.”

⁸ Shihni, ndër të tjera, vendimin nr. 4/2019, paragrafi 37.2.2.; vendimin nr. 23/2020, paragrafi 26.3; vendimin 14/2021, prg. 44; vendimin nr. 22/2021, paragrafi 27.4; vendimin nr. 3/2023, paragrafi 23.7.3 etj., të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁹ Protokolluar pranë Komisionit, me nr. ***/*, datë **.1.2018.

kontratë punësimi, si shkak i kohës së gjatë që ka kaluar.

1.6.6.1 Kolegji ka arsyetuar në jurisprudencën e tij se deklaratat noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratave noteriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit¹⁰.

1.6.6.2 Referuar akteve në dosje, lidhur me burimin e shumës 12.000 euro, të deklaruar dhe pretenduar gjatë hetimit administrativ, në aktet në dosje, konstatohet se subjekti nuk i ka deklaruar këto të ardhura në deklaratën vjetore të vitit 2003, por ka deklaruar vetëm pagën e personit të lidhur nga shoqëria “**** ****”, nuk ka një kontratë pune, ku të identifikohen marrëdhëniet me punëdhënësin dhe pagesa e pretenduar, nuk gjendet asnjë e dhënë mbi mënyrën se si është kryer kjo pagesë dhe nëse për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore, për t’i konsideruar ato si atë ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 84/2016.

1.6.6.3 Vlen të theksohet se, nga analiza financiare dhe verifikimi i të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj, Komisioneri Publik konstaton se, për periudhën 2000-2003, në të cilën subjekti deklaroi se ka shpenzuar rreth 3.000.000 lekë¹¹, për krijimin e 1/3 të pasurisë, dhe 3.000 deri në 4.000 euro për mobilim, të ardhurat e ligjshme nuk i mbulojnë këto shpenzime të deklaruara. Të ardhurat e ligjshme në këtë periudhë, të vërtetuara me dokumentacion ligjor provues¹², rezultojnë në shumën 1.869.447 lekë.

1.6.6.4 Kolegji, bazuar në pikën 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës: *[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...]*, në jurisprudencën e tij, ka arsyetuar se, për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kritere, që: (i) janë deklaruar dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjisllacionit në fuqi, duke arritur në konkluzionin që në analizë duhet të përfshihen vetëm të ardhurat që plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës.

1.6.7 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, kërkuesja nuk arriti të provonte të kundërtën e këtij shkak të ankimit, duke mbetur në konsideratë se për këtë pasuri, subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

¹⁰ Referohuni, ndër të tjera, vendimit (JR) nr. 11/2019, datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.1; vendimit (JR) nr. 34/2019, datë 2.12.2019, paragrafi 85.2; vendimit (JR) nr. 2/2020, paragrafi 20.5; vendimit (JR) 29/2020, paragrafi 32.5.

¹¹ Referuar formularit të vetëdeklarimit për legalizimit të objektit, me aplikant z. ****, datë 3.3.2013, *Shtojca A*, vlera e deklaruar e objektit për të cilin është paguar taksa e infrastrukturës është 17.808.414 lekë, për tri familje. Pra, duket se vlera e ndërtimit të jetë më e lartë.

¹² Vërtetim, i datës 10.10.2016, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës; Vërtetim nr. ***/*, datë 10.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës, si dhe bazuar në listëpagesat e shoqërisë “****” sh.p.k.

2. Për të ardhurat nga puna e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, në Arabinë Saudite, në shumën 18.970 USD, deklaruar në Deklaratën vjetore për vitin 2006

2.1 Në deklaratën e interesave vjetorë të vitit 2006, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: Llogari rrjedhëse në \$, në Bankën ***, çelur në muajin prill 2006. (Në këtë llogari janë transferuar me transfertë ndërkombëtare të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti, si inxhinier topograf, pranë shoqërisë “****”, në Arabinë Saudite). Shuma 18.970 \$. Po në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga puna e bashkëshortit, si inxhinier topograf, pranë shoqërisë “****”, në Arabinë Saudite, në shumën 20.000 \$.

2.2 Nga aktet në dosje, rezulton se ILDKPKI-ja, më shkresën nr. ***/* prot., datë **.12.2017, drejtuar Komisionit, në lidhje me këto të ardhura, shprehet se: “...nuk janë përfshirë të ardhurat në shumën 20.000 USD, në Arabinë Saudite, pasi nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues”.

2.3 *** Bank ka konfirmuar se, në datat ** prill 2006 dhe ** korrik 2006, janë kryer dy transfertë, përkatësisht në shumat 9.982,97 USD dhe 9.987,26 USD, gjithsej 19.975,23 USD, 18.970 USD, sikundër deklaruar nga subjekti.

2.4 Komisioni, nisur nga korrespondenca me *** Bank, ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e dhënë nga *** Bank, ku konfirmohet urdhëruesi i transfertës, pa analizuar burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave.

2.5 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe në rastin konkret, të ardhurat e deklaruara nga kërkuesja nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Kërkuesja, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, nuk provoi se për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore, me qëllim që ato të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.

2.6 Kërkuesja, duke qenë subjekt i deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, duhet të kishte akte, ku të provohej punësimi i pretenduar i bashkëshortit, kontrata e punësimit në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, përfshirë mënyrën apo formën e marrjes së pagës, cilës palë i përket detyrimi për pagesën e tatimit mbi të ardhurat dhe masa e detyrimit tatimor të paguar. Vetëm fakti që në llogarinë në USD të kërkueses ka kaluar në total shuma prej 19.975,23 USD, nëpërmjet transfertave përkatëse të datës **.4.2006, në shumën 9.982,97 USD, dhe të datës **.7.2006, në shumën 9.987,26 USD, me të njëjtin përshkrim: “Receipt of *** ****”¹³, me urdhërues “**** *** ** 8 50018 S”, dhe e pretenduar si e ardhur nga puna e bashkëshortit, si inxhinier topograf, pranë shoqërisë “****”, në Arabinë Saudite, nuk është i mjaftueshëm për të legalizuar këtë vlerë si të ardhur të ligjshme në kuptim të dispozitave të mësipërme dhe të praktikës tashmë të konsoliduar të Kolegjit¹⁴.

2.7 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurive, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter lidhur me burimet financiare të ligjshme për të justifikuar një pjesë të pasurive të saj, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

¹³ Referohuni përgjigjes së *** Bank, dërguar Komisionit, me shkresat nr. ***/* prot., datë **.2.2018; nr. ***/* prot., datë **.2.2018; nr. ***/* prot., datë **.3.2018.

¹⁴ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nr. 23/2020 (JR), paragrafi 25.4; nr. 35/2021(JR), paragrafi 18.6.

B. Lidhur me rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

3. Komisioni, ndër të tjera, në vlerësimin e 5 dosjeve penale të trajtuara në Raportin e aftësive profesionale, për rastin nr. 5, ka konstatuar se kërkuesja nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit nr. ***, datë **.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për “Pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit ***. ***, ***,”, vendim me të cilin subjekti është njohur dhe ka qenë prezent në seancën gjyqësore.

3.1 Nga aktet, Komisionit i ka rezultuar se. në vitin 2015. është regjistruar procedimi penal nr. ***, ndaj të pandehurit ***. ***, hetuar në gjendje të lirë për akuzën e veprës penale, refuzim për deklaram/mosdeklaram/fshehje ose deklaram i rremë i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, parashikuar nga neni 275/a/1 i Kodit Penal. Kjo çështje është dërguar për gjykim më datë **.2.2016. Procesi ka qenë i mbështetur mbi materialin kallëzues të ILDKPKI-së.

3.1.1 Nga aktet konstatohet se prokurori ka kryer veprimet hetimore të duhura dhe, në diskutimet përfundimtare, më datë **.6.2016, ka kërkuar deklaramin fajtor të të pandehurit për veprën penale të referuar. Me aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, përfundimisht, ka kërkuar dënimin e të pandehurit me 4 muaj burgim.

3.1.2 Gjykata e Shkallës së Parë, me vendimin e saj nr. ***, datë **.6.2016, në prezencë të prokurorit, ka vendosur pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit ***. ***. Sipas verifikimeve rezultojnë se vendimi është zbardhur, dosja është dorëzuar brenda afatit ligjor të parashikuar, për të ushtruar secila nga palët të drejtën e ankimit.

3.1.3 Konstatohet se në këtë rast, kërkuesja nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit. Më datë **.7.2016, është bërë një kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit për një rast faktor, sikurse është shprehur vetë prokurori, e dokumentuar kjo me dokumentacion. Gjithashtu, në kërkesën për rivendosje në afat, kërkuesja ka parashtruar se ditët e para të dhënies së vendimit është pritur zbardhja e tij, me qëllim të depozitohet ankimi i arsyetuar. Ky fakt është sqaruar në analizën e provave që i përket vendimit të pushimit.

3.1.4 Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin e saj nr. *** akti, datë **.10.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit pranë Gjykatës dhe, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “Gjykata krijon bindjen se nuk kemi të bëjmë as me rast faktor dhe as me forcë madhore”. Sipas fletës së numërorit të vendimeve rezultojnë se dosja është depozituar në Sekretari brenda afatit dhe nuk rezultojnë që ndaj këtij vendimi të jetë depozituar ankim nga kërkuesja.

3.2 Në lidhje me humbjen e të drejtës së ankimit, subjekti i rivlerësimit, në seancën dëgjimore të datës 13.7.2018, është shprehur para Komisionit se: *[...] E dëgjova me kujdes raportin. Konstatoj që ai është i drejtë... Është i drejtë edhe konstatimi i mosushtrimit të apelit për rastin e të pandehurit ***. ***. Siç është shpjeguar dhe në komunikimin tim me ju..., pas njohjes me rezultatet e hetimit, – kjo ka ndodhur për shkak se ka qenë e nevojshme dhe e domosdoshme që unë gjatë kësaj periudhe kohore të kujdesesha për një familjar timin, i cili ishte i sëmurë rëndë, në kushtet kur dhe babai i mbesës ishte i sëmurë rëndë. Menjëherë, sapo unë kam konstatuar, kam mbledhur dokumentacionin e nevojshëm dhe kam bërë kërkesë, ashtu siç u deklarua dhe*

në këtë seancë dëgjimore, për rivendosje në afat, kërkesë e cila u çmua nga Gjykata e Shkallës së Parë, që nuk i përmbushte kushtet e rastit faktor.

Në këtë moment, unë jam njohur më thellësisht me praktikën gjyqësore dhe kam folur, dhe me prokurorë të Apelit dhe si konkluzion është arritur në përfundimin që rasti që unë paraqita para gjykatës, në fakt nuk përbënte rast faktor. Praktika gjyqësore e lidhte rastin faktor me raste të rënda të vetë subjektit të rivlerësimit, siç mund të ishin aksidente traumatike në gjendje kome apo sulme kriminale që e mbanin vetë subjektin që kishte të drejtën procedurale të ankimit të izoluar dhe e çonin atë në pamundësi objektive. Kur u binda se pavarësisht se kisha shkak njerëzor që nuk bëra apelin, ai nuk përbënte shkak faktor dhe për këtë arsye nuk vazhdova më tej, sepse mendova që nuk ishte më efektive [...].

3.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, humbja e afatit të ankimit kundër vendimit nr. ***, datë **.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për “Pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit ***, ****”, si dhe pohimi nga ana e subjektit të rivlerësimit se, deri në momentin e mospranimin nga Gjykata të kërkesës për rivendosje në afat, nuk e njihte mjaftueshëm praktikën gjyqësore në lidhje me trajtimin ligjor të rastit faktor, provon se për rastin në fjalë, kërkesja ka shfaqur mungesë të aftësive profesionale dhe të atyre organizative.

3.4 Komisioneri Publik vlerëson se mbetet e provuar se, edhe në konsideratë të pretendimit të kërkueses, se mund të ketë qenë në kushtet e pamundësisë për të ushtruar personalisht të drejtën e ankimit kundër vendimit të Gjykatës brenda afatit ligjor, për sa kohë e konsideroi të padrejtë atë vendim, duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për të njoftuar organin e Prokurorisë për këtë pamundësi, pasi ky organ, për shkak të organizimit dhe mënyrës së funksionimit të tij, i kishte të gjitha mundësitë dhe mjetet ligjore që të mos e humbiste të drejtën e ankimit, por të mund ta ushtronte atë nëpërmjet një prokurori tjetër.

3.5 Të gjitha përpjekjet e mëpasshme të znj. Sevdari, për të riparuar pasojat e humbjes së afatit të ankimit, kanë rezultuar se janë vlerësuar nga Gjykata të papranueshme dhe, për pasojë, është rrëzuar dhe kërkesa e paraqitur prej saj për rivendosje në afat, me arsyetimin se subjekti nuk ndodhej në kushtet e rastit faktor. Komisioneri Publik vlerëson rëndësinë që paraqet ndjekja penale e veprave me natyrë ekonomike nga zyrtarët publikë, me ndikim në rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

3.6 Sa më sipër, Komisioneri Publik arsyeton se, në rastin konkret, kërkesja ka reflektuar njohuri dhe gjykim të dobët, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe si i tillë duhet vlerësuar, së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

Kërkimi i ankimit

4. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

4.1 Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;

4.2 Nisur nga fakti se Kolegji i shqyrton çështjet dhe vendos standardet në bazë të parimeve kushtetuese kur gjykohet çështja prej tij, si dhe në bazë të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton institucionet e rivlerësimit për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme;

4.3 Bazuar në nenet Ç, D, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

4.4 Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO